



A.nr. 487/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.487/2026, të datës 30.04.2026, të parashtruar nga ankuesja A.M nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike-administrative “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 22.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.487/2026, e datës 30.04.2026, e parashtruar nga ankuesja A.M.

A r s y e t i m

Ankuesja A.M (*tutje referuar ankuesi*), përmes emailit më datë 29.04.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 30.04.2026 nën shenjën A.nr.487/2026, kundër avancimit të zyrtarit tjetër në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa, si rezultat i ristrukturimit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.05.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ndërsa, ky i fundit më datë 14.05.2026, ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2129/2026 të datës 30.04.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 04.03.2026 nga ankuesja për K.B; Emailin e datës 05.03.2026 nga K.B për ankuesen; Emailin e datës 27.04.2026 nga L.A; Kopjen e ID-së së ankueses; Emailin e datës 29.04.2026 nga ankuesja për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.05.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 14.05.2026; Akt Emërimit AE.Nr.02.2022 të datës 02.09.2022 të ankueses; Vendimin me Nr. 03/26 të datës 19.01.2026, të Njësia e Burimeve Njerëzore e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për transferim në pozitën Zyrtare Administrative; Vendimin e datës 04.09.2025 për formimin e Komisionit të Ristrukturimit në KKTK; Plotësim ndryshmin e vendimit datë 16.09.2025 për formimin e Komisionit të Ristrukturimit; Vendimin e datës 31.10.2025 për miratimin e përshkrimit të vendeve të

punës; Raportin përfundimtar të komisionit të ristrukturimit i datës 24.11.2025; Akt Emërimit e datës datë 23.04.2026.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses është e palejuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rezulton, se ankuesja fillimisht sipas Akt Emërimit AE.Nr.02/2022 të datës 02.09.2022, ka qenë e punësuar në pozitën Zyrtare Administrative në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Më datë 01.08.2025, është miratuar Rregullorja Nr. 03/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Tutje sipas Vendimit me Nr. 20/2025 të datës 04.09.2025, të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, është themeluar Komisioni i Ristrukturimit në këtë institucion, përkatësisht sipas Vendimit me Nr.22/2024 të datës 16.09.2025, është bërë plotësim ndryshimi i vendimit paraprak, me të cilin Komisionit të Ristrukturimit i janë dhënë detyra në hartimin e përshtimit të vendeve të punës.

Komisioni i Ristrukturimit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, më datë 24.11.2025 ka përgatitur raportin përfundimtar me Nr.26/25, duke propozuar që ankuesja të sistemohet në pozitën Zyrtare Administrative në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm. Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, më datë 19.01.2026, ka nxjerr Vendim me Nr. 03/26, me të cilin ankuesen e ka transferuar nga pozitë Zyrtare Administrative në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm në pozitën Zyrtare Administrative në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm , që nënkupton se nuk ka ndonjë ndryshim të pozitës së ankueses.

Ankuesja më datë 04.03.2025, përmes emailit ka kërkuar nga Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, që nuk mund të avancohen zyrtarët nga kategoria më e ulët në atë me të lartë duke aluduar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa, duke konsideruar që duhet të shpallet konkurs për këtë pozitë. Ndërsa Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, përmes emailit të datës 05.03.2026, ka njoftuar ankuesen e a e pranoni apo jo pozitën sipas ristrukturimit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se fillimisht është ndryshuar vendimi për formimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe rrjedhimisht këtij komisioni i janë dhënë të drejta për hartimin e përshtimit të vendeve të punës që nuk është mandat i tij, pretendon se komisioni i ristrukturimit e ka caktuar z. H. D nga pozita e kategorisë profesionale në pozitë të kategorisë së ulët drejtuese pra Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa, pretendon se për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa duhet të shpallet konkurs dhe të emërohet kandidati sipas konkursit duke na dhënë mundësim të konkurrojmë. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet procedura e re sistematizimit në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa dhe të obligohet institucioni që për këtë pozitë të zhvillojë procedurë sipas konkursit.

Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të çështjes, ka konstatuar se ankuesja fillimisht sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.02/2022, të datës 02.09.2022, ka themeluar marrëdhënie pune në pozitën Zyrtare Administrative, në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, e cila pozitë, sipas Rregullores Nr.03/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, nuk është shuar apo ndryshuar, kështu që Komisioni i Ristrukturimit në këtë institucion ka propozuar transferimin e ankuses në pozitë të njëjtë, e kjo ka rezultuar me Vendimin me Nr.03/26 të datës 19.01.2026, të Njësia e Burimeve Njerëzore e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Rrjedhimit sipas provave të lëndës, ankuesja Vendimin me Nr.03/26 të datës 19.01.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për transferim në pozitën Zyrtare Administrative, e ka pranuar përmes emailit më datë 20.01.2026, ndërsa sipas këshillës juridike të këtij vendimi: *Pala e pakënaqur me këtë vendim, ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bende afatit prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi*, ndërsa sipas shkresave të lëndës, ankuesja nuk ka parashtruar ankesë ndaj këtij vendimi si akt me të cilin është vendosur për pozitën e ankuses dhe për marrëdhënien e punës së ankuses.

Tutje, Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se përderisa ankuesja nuk e ka kontestuar Vendimin me Nr. 03/26 të datës 19.01.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, nuk ka ndonjë akt apo veprim me të cilin ankuses i është cenuar e drejta nga marrëdhënia e saj e punës të cilën marrëdhënie e ka të themeluar sipas aktit të emërimit, kështu që në kuptim të pranushmërisë së ankesës Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe nenit 124, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...”*, Kolegji i Këshillit, nisur nga konstatimet si më lart se ankuses me asnjë akt nuk i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e punës sepse veprimet që ankuesja i konteston nuk kanë fare të bëjnë me marrëdhënien e saj të punës, pra, nuk kemi veprim apo mos veprim të organit kompetent në raport me marrëdhënien e punës së saj, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës aktive në procedurë, kështu që, ankesa e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konsiderohet e papranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurës së Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji”*.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.487/2026, më datë 22/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.M;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.